

VENDIM
Nr. 272, datë 4.5.2023

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE NR. 1020,
FSHATI ALLPRENAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM, BASHKIA LUSHNJË,
QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “5GX ENERGY” SHPK**

(Ndryshuar me VKM-në 486, datë 24.7.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k.;
- b) Numri i identifikimit personal, NIPT/NUIS: M27511801Q;
- c) Tipi centralit: Fotovoltaik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier;

- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., ka detyrimin që:
i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.


2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "5GX ENERGY" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1
(Ndryshuar me VKM-në nr. 486, datë 24.7.2024)

Koordinatat e Centralit Elektrik Fotovoltaik Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier Shoqëria "5GX ENERGY" sh.p.k.											
KOORDINATAT NË KRGJSH											
Nr.	E	N	Nr.	E	N	Nr.	E	N	Nr.	E	N
1	474404.14	4536875.66	6	474714.42	4536892.28	11	474744.23	4536514.31	16	474480.19	4536698.28
2	474446.49	4536883.53	7	474808.53	4536837.73	12	474657.52	4536571.62	17	474457.53	4536742.48
3	474499.34	4536957.47	8	474786.68	4536779.08	13	474646.66	4536580.45	18	474416.99	4536742.48
4	474529.61	4536988.01	9	474747.21	4536612.86	14	474581.89	4536531.97	19	474413.46	4536833.4
5	47467.17	4536983.1	10	474770.16	4536570.24	15	474467.015	4536629.185	20	474413.97	4536853.303



SHKALLA 1:25000
Sipërfaqe totale e koordinatave = 123380m2

KORDINATAT NE KRGJSH											
NR	E	N	NR	E	N	NR	E	N	NR	E	N
1	474004.14	4536875.66	6	474714.42	4536892.28	11	474744.23	4536514.31	16	474880.39	4536698.28
2	474446.49	4536883.53	7	474806.53	4536837.73	12	474657.52	4536571.62	17	474857.53	4536742.48
3	474499.34	4536957.47	8	474786.68	4536779.08	13	474646.66	4536580.45	18	474816.99	4536809.1
4	474529.61	4536988.01	9	474747.21	4536612.86	14	474581.89	4536531.97	19	474813.46	4536833.4
5	474678.17	4536983.1	10	474770.16	4536670.24	15	474467.015	4536620.185	20	474813.97	4536853.303